# Hetimet për vrasjen e biznesmenit Edmond Papa

Shpërndaje

13:05 17/12/2022

Pasditen e djeshme, biznesmeni Edomond Papa u qëllua në zonën e "Selitës" në Tiranë në një atentat mafioz.

49-vjeçari u qëllua në një lokal nga një person akoma i paidentifikuar.

Në vendin e ngjarjes, ndodhet gazetari Merin Maçi, i cili ka zhvilluar një lidhje direkte për edicionin e lajmeve në Tv Klan, ku dhe ka dhënë më shumë detaje për hetimet që po kryhen në lidhje me ngjarjen e rëndë.

***Pyetje: Çfarë detajesh të reja kanë dalë nga ngjarja?***

**Merin Maçi:** *Unë ndodhem në pjesën e përparme të bar kafes ku u zhvillua e gjithë ngjarja e rëndë mbrëmjen e së premtes. Viktima, 49-vjeçari Edmond Papa, i cili rezulton se ka përdorur edhe një emër tjetër, i njohur si* ***Edmond Hoxha*** *ka qenë i pozicionuar në krahun tim të majtë, pikërisht në pjesën e jashtme të bar kafes kur autori ende i paidentifikuar është futur në brendësi të saj, ka hapur zjarr dhe viktima ka tentuar që të shmanget duke u larguar dhe duke e qëlluar atë me çfarëdolloj sendi që kishte pranë.*

*Nga të shtënat, ai ka rënë në tokë në zonën e brendshme të bar kafes, e cila vijon të jetë e rrethuar me shiritat e skenës së krimit dhe më pas kanë qenë qytetarët të rastit, të cilët i kanë dhënë ndihmën e parë dhe më pas gjatë rrugës për në Spitalin e Traumës, ai nuk ka mundur që t'i mbijetojë plagëve të marra.*

*Duhet thënë se banesa ku ai po qëndronte pas ardhjes nga Saranda është banesa e familjarëve të tij që ndodhet përballë bar kafes ku unë po raportoj dhe sapo ka lënë atë, autori të paktën sipas dyshimeve, e ka pritur për disa minuta sapo është futur në ambientet e bar kafes dhe më pas ka vijuar me planin e tij derisa ka finalizuar ekzekutimin.*

*Autori është fiksuar nga kamerat e sigurisë teksa lëvizte i vetëm dhe të njëjtin itenerar ka përshkuar duke u larguar nga vendngjarja dhe duke u larguar në këmbë me shpejtësi.*

*Nga kqyrja që iu është bërë kamerave të sigurisë në zonë, për të cilat duhet thënë se ka një numër të lartë, autori akoma i paidentfikuar ishte i veshur me rroba të zeza dhe shihet se mbante në kokë kapuçin e një bluze. Kjo për të mos rënë në sy dhe për të mos u identifikuar nga kamerat e sigurisë që ndodhen në zonë pasi hetuesit dyshojnë se autori e ka studiuar rrugën ku do të lëvizte, por edhe vendin ku do të kryente atentatin mafioz ndaj 49-vjeçarit./**tvklan.al***

## TË NGJASHME



**33-vjeçari spërkat me benzinë Policinë e Elbasanit dhe i vendos flakën murit rrethues**

18:36 17/12/2022

**Makina përplas 59-vjeçarin me biçikletë në Shkodër**

18:14 17/12/2022

**Makina përplas 60-vjeçaren në kryeqytet**

18:05 17/12/2022

**Shpërthen bombola e gazit, plagosen 3 anëtarët e familjes**

16:22 17/12/2022

**Tv Klan sjell në 3D skenën e vrasjes së biznesmenit**

14:38 17/12/2022

**I shpallur në kërkim për krijimin e skemave mashtruese me tatimin mbi vlerën e shtuar, arrestohet 60-vjeçari**

13:05 17/12/2022

**Hetimet për vrasjen e biznesmenit Edmond Papa**

12:05 17/12/2022



**Lëvizte me armë në makinë, arrestohet 44-vjeçari**

10:46 17/12/2022

**Lihen në burg Marjeta Karaj dhe Gazmir Ngota, akuzohen për vrasjen e Menduh Kurt-Dedës në 2017**

09:59 17/12/2022



© 2022 TV Klan. All Rights Reserved.